



01-30M

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-35719/25 dt. 11.03.2025, të Halil dhe Gresa Gashi, Basri Gashi dhe Hamdi Makolli nga Prishtina dhe investitorit “Dulon Group” sh.p.k. me adresë, Fshati Gllarevë, rr. “Idriz Balaj”, pn. Klinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër parcelës ndërtimore “F-10-2” të bllok bllokut urban “b-17”, të nën tërësisë “B-4”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 28.05.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Halil dhe Gresa Gashi, Basri Gashi dhe Hamdi Makolli nga Prishtina dhe investitorit “Dulon Group” sh.p.k. me adresë, Fshati Gllarevë, rr. “Idriz Balaj”, pn. Klinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811905225, me përfaqësues Astrit dhe Gentonis Balaj nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-35719/25 dt. 11.03.2025, përdorimi i ndërtesës shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “Ndërtesa KF 10” me etazhitet 2B+P+11ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-181263/20 dt. 05.11.2021 dhe Vendimit me nr. 05 Nr. 351/02-181263/20/01 dt. 26.05.2022 për “Miratimin e ndryshimit të akteve administrative: Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore nr. 05Nr.350/02-256708/17 dt.19.09.2020, Aktvendimi për caktimin e taksës administrative, nr. 05 Nr. 351/02-181263 dt.30.08.2021 dhe Vendim-Leje ndërtimore, nr. 05Nr. 351/02-181263/20 dt. 05.11.2021”, në kuadër bllokut urban “b-17”, të nën tërësisë “B-4”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 2595-9, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ali Ahmeti” dhe “Shaip Kamberi” ku janë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 72, 74 dhe 162 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Pronarët Halil dhe Gresa Gashi, Basri Gashi dhe Hamdi Makolli nga Prishtina dhe “Dulon Group” sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit ARBK 811905225, me përfaqësues Astrit dhe Gentonis Balaj nga Gllareva, Klinë, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-35719/25 dt. 11.03.2025, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, të emërtuar, me

etazhitet 2B+P+11ET, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 2595-9, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-181263/20 dt. 05.11.2021 dhe Vendimit me nr. 05Nr. 351/02-181263/20/01 dt. 26.05.2022 për “Miratimin e ndryshimit të akteve administrative: Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore nr. 05Nr.350/02-256708/17 dt.19.09.2020, Aktvendimi për caktimin e taksës administrative, nr. 05 Nr. 351/02-181263 dt.30.08.2021 dhe Vendim-Leje ndërtimore, nr. 05Nr. 351/02-181263/20 dt. 05.11.2021”, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-9957/25 dt. 04.03.2025, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i vend punishtes Kushtrim Zekolli; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Ramadan Aliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Arban Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Florim Bajrami; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Korab Lushta; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Arban Shala, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Faton Bajselmani me nr. të licencës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Sipas dëshmisë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 2595-9, Zona Kadastrale Prishtinë, pronar/posedues të parcelës së lartë cekur, janë Halil dhe Gresa Gashi, Basri Gashi dhe Hamdi Makolli nga Prishtina, pasi që, në ndërkohë, me aktet noteriale; “Aktvendim mbi bartjen e trashëgimisë” të përpiluar te notere Valdete Ademi në Prishtinë me Nr. LRP-së 1164/2023 dhe Nr. REF. 304/2023, dhe “Aktvendim mbi bartjen e trashëgimisë” të përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë me Nr. LRP-së 5274/2024 dhe Nr. REF. 2436/2024, janë ndërruar pronarët/poseduesit e parcelës së lartë shënuar, dhe rrjedhimisht Certifikata e Përdorimit lëshohet në emër të të njëjtëve.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e

certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-së

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-35719/25 DT. 28.05.2025**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



